



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 11 / 2, datë 01 / 02 / 2018

PËR

MARRJEN E MASËS DISIPLINORE
“SHKARKIM NGA DETYRA”

Sot në datën 01 / 02 / 2018 unë Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, nisur nga shkeljet disiplinore shumë të rënda të kryera nga z. Kadri Skera, Avokat Shteti pranë APSH, vlerësoj se shkeljet e tij përbëjnë shkak për procedim disiplinor sipas ligjit, dhe

VËREJ SE,

Avokati Përgjithshëm i Shtetit, ka nxjerrë Urdhrin nr.11, datë 25.01.2018 “Për ushtrim inspektimi tematik në lidhje me trajtimin e shkresës nr. 2238 prot, datë 18.05.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, sigluar për ndjekje Avokatit të Shtetit Kadri Skera”, me objekt: Informimin paraprak të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në lidhje me trajtimin e praktikës së mësipërme dhe raportimi në Zyrën e Inspektimit në lidhje me hapat konkret të ndjekura nga Z. Skera, për sa njoftohet në kopjen e kërkesës për gjykim, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kavajë.

Nga Raporti i Inspektimit dhe seanca dëgjimore me Z. Skera, u konstatua se:

Se pari: Praktika e mësipërme, e prokurorisë është protokolluar me nr.386, datë 19.05.2016 pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe në dt. 20.05.2016 dhe i është sigluar për trajtim avokatit të shtetit z. K. Skera, i cili nuk ka kryer asnjë veprim ligjor nga momenti i siglimit të praktikës dhe në vazhdim.

Së dyti: Z. Skera nga momenti që u informua me kërkesën e dërgimit në gjyq të çështjes penale, duhet të kishte hartuar padinë civile në procesin penal, për shkak se me pronën e përvetësuar nga të pandehurit në kundërshtim me ligjin, janë cënuar rëndë interesat pasuror të shtetit, pasi sipërfaqja e përfutur në kundërshtim me ligjin është 985.900 m² dhe siç rezulton nga vendimet gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurve dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 576, datë 11.07.2017 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë duke ndryshuar vendimin e mësipërm vetëm për një nga të pandehurit.

Së treti: Z. Skera, nuk ushtruar detyrën funksionale si Avokat Shteti, që konsiston në mosinformimin në mënyrë shkreore të organit të Prefekturës Tiranë, për vazhdimin e procedurave ligjore, duke qënë organi kompetent i cili kundërshton në gjykatë, titujt e pronësisë të dhëna në kundërshtim me ligjin.

Së katërti: Ndaj Z. Skera, janë nxjerrë dhe Urdhëri me nr.33 datë 04.04.2012 dhe Urdhëri nr.11 datë 17.01.2014, për marrjen e masës dispilnore - *vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra*- që tregojnë se ka qënë në vijimësi neglizhent në ushtrimin e detyrës së tij si Avokat Shteti.

Si përfundim, gjykojë së veprimet të tilla janë në shkelje shumë të rëndë të ligjit dhe akteve ligjore e nënligjore dhe përbëjnë shkak për mase disiplinore shkarkim nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Në bazë të nenit 29/2, 30/1/c dhe 31/3/c të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit“, si dhe të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me urdhrin nr. 275/1, datë 14 Janar 2009 të Ministrit të Drejtësisë,

URDHËROJ,

1. Marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Përgjithshme z. Kadri Skera, për shkelje shumë të rënda disiplinore në punë, në referim të neneve 30/1/c , dhe 31/2/c të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.
 2. Z. Kadri Skera të bëjë dorëzimin e dokumentacionit që disponon, me procesverbal tek nëpunësja e protokollit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.
 3. Për efektet financiare, ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhëri, Zyra e Financës.
 4. Ky urdhër ti komunikohet nga Zyra e Protokollit z. Kadri Skera, i cili ka të drejtën e ankimit të urdhrit në gjykatën kompetente.
 5. Zyra e Protokollit të marrë masa për zbatimin e këtij urdhri.
- **Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT



ALMA HICKA